



Pranimar / Dorezuar Primihera/Pradato Receipted/Deivety	21.06.2023	3	viti god year
Organ /Rjeshta Organ /Jedimica Org /Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtesa a Eniq Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANBERK	4854	/2023	919



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.694/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-Anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtsit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.694/2023 të datës 02.05.2023 të parashtruar nga

kundër organit të punësimit Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 19.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.694/2023 të datës 02.05.2023 të parashtruar nga

A r s y e t i m

Ankuesi _____ përmes përfaqësuesit të autorizuar, kanë parashtruar ankesë përmes postës së Republikës së Kosovës me datë 27.04.2023 e cila në Këshill është pranuar me datë 02.05.2023 me numër protokollit 3982/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër vendimit të Komunës së Prishtinës me numër 14-101/03-51822/23 i datës 09.03.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.05.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa Këshilli më datë 31.05.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës, me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me datë 14.06.2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesve edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 3982/2023 të datës 02.05.2023 e parashtruar nga _____ grup ankuesish në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Komunës së Prishtinës me numër 14-101/03-51822/23 i datës 09.03.2023; Vendim i KPMSHCK me numër A.nr.26/2022 me numër protokolli 761/2022 i datës 14.02.2022; Ankesë me numër protokolli 1260/2020 e datës 02.07.2020; Kërkesë për Njësine e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës e datës 27.02.2020; Akt Emërim i J.M. i datës 20.05.2019; Akt Emërim i R.P. i datës 20.05.2019; Akt Emërim i D.T. i datës 20.05.2019; Akt Emërim i I.A. i datës 20.05.2019; Njoftim me numër protokolli 14-030/01-61757/20 i datës 18.03.2020; Autorizimet e noterizuara të ankuesve për avokatin N.S. të datës 24.01.2020; Njoftim nga M.LI. i datës 27.04.2023; E-mail nga V.Z. për F.L. i datës 23.08.2021; Pliko me numër R5226298 i datës 27.04.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 31.05.2023; Akt Emërim i J.M. i datës 29.07.2021; Akt Emërim i D.T. i datës 29.07.2021; Akt Emërim i I.A. i datës 29.07.2021; Përshkrimi i detyrave të punës; E-mail nga F.L. për A.Z. i datës 09.07.2019; Vendim i Kryetarit të Komunës së Prishtinës me numër 14-112/02-149662/21 i datës 27.07.2021; Vendim i KPMSHCK me numër VK/2023 i datës 14.06.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që të përfundoi procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.694/2023 i datës 02.05.2023 të parashtruar nga _____ grup ankuesish, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi _____ sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.01nr.112-1248 të datës 29.07.2021 është i punësuar në pozitën "Zyrtar për Shërbim me Qytetar" në kuadër të Drejtorisë së Administratës në Komunën e Prishtinës, ankuesi _____ sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.01nr.112-1247 të datës 29.07.2021 është i punësuar në pozitën "Zyrtar për Shërbim me Qytetar" në kuadër të Drejtorisë së Administratës në Komunën e Prishtinës, ankuesi _____ sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.01nr.112-1241 të datës 29.07.2021 është i punësuar në pozitën "Zyrtar për Shërbim me Qytetar" në kuadër të Drejtorisë së Administratës në Komunën e Prishtinës dhe ankuesi _____ sipas Akt Emërimit me 01nr.112-1145 të datës 20.05.2019 është i punësuar në pozitën "Zyrtar për Shërbim me Qytetar" në kuadër të Drejtorisë së Administratës në Komunën e Prishtinës.

Ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kanë parashtruar ankesë me pretendimin ankimor kundër vendimit të Komunës së Prishtinës me numër 14-101/03-51822/23 i datës 09.03.2023 për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të ligjit për shërbimin civil, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale sepse nuk janë

aplikuar drejt dispozitat ligjore për shkak se në procedurë nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës sepse është konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendja faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ankesës së ankuesve, ka konstatuar se lidhur me pretendimet e njëjta ankimore për të njëjtë çështje lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve nga Komuna e Prishtinës për të njëjtën Këshilli ka vendosur meritorisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 02.07.2020 ka pranuar ankesën me numër A.nr.179/2020 nga ankuesit, ndërsa me datë 14.02.2022 me numër protokolli 761/2022 ka nxjer vendim me të cilin është aprovuar si e bazuar ankesa me numër A.nr.179/2020 e datës 02.07.2020 e parashtruar nga ankuesit

Ndërsa bazuar në vendimin e nxjerr nga Komuna e Prishtinës me numër 14-101/03-51822/23 i datës 09.03.2023 të njëjtin e ka zbatuar.

Bazuar në këtë Kolegji konstaton se meqenëse Këshilli brenda periudhës dy vjeçare ka vendosur për ankesën e ankuesve, atëherë ankesa e grup ankuesish rrjedhimisht është e konsumuar pasi që Këshilli ka vendos sipas Vendimit me numër A.nr.26/2022 të datës 14.02.2022 me numër protokolli 761/2022, atëherë Kolegji konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës së ankuesit komfor dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike*". Kolegji konstatoi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.694/2023 të datës 02.05.2023 të parashtruar nga grup ankuesish.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.694/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve avokatit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

